



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:283330

Datë: 11.05.2022

Numri i dokumentit: 02996628

P.nr.1022/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me zyrtaren ligjore Fikrije Rexhepi, ne çështjen penale ndaj të pandehurit R.. S.. nga Gj.. ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 314, paragrafi 1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.2031/2021 të datës 15.12.2021, të cilën e përfaqëson prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 10.05.2022 publikisht shpalli, ndërsa më 11.05.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **R.. S..**nga i ati O.. nëna H., e lindur S...., i lindur më.., me numër personal..., në Gjilan, ku edhe jeton në rr.”...” ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i shtatë fëmijëve, i papunë, marrës i ndihmë sociale, me nr personal..., i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar.

ËSHTË FAJTOR

S E P S E

Prej datës së pavërtetuar deri me datë 28.09.2021 në shtëpinë e tij në Gj..., i pandehuri në mënyrë të paautorizuar si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetit t’i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka vjedhur energji elektrike, ashtu që njehsorin elektrik e ka të vendosur me komandë nga distanca (AMR), ku për shkak të borxhit është shkyqur nga rrjeti elektrik dhe pas kontrollit nga punëtorët e autorizuar të, është konstatuar se i njëjti është lidhur direkt në rrjetin elektrik, ku ka bërë harxhim të paautorizuar, dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS-in, Distrikti në Gj..., i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 54.76Euro.

-me çka ka kryer veprën penale **Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 314, paragrafi 1, të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve, 4,7,17,38,39,40,43,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK-së), të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

I. Ashtu që të akuzuarit i i caktohet **dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtëdhjet (90) ditë**, dhe ne të njëjtën kohë urdhërohet që ky dënim mos të ekzekutohet, nëse i akuzuari në fjalë nuk kryen veper tjeter penale gjatperiudhës verifikuese në afat prej një viti, duke filluar nga dita e formës së prerë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të revokimit të tij të nenit 50 ose 51 të KPRK-së

II. Pala e dëmtuar **K..E..D.S.-in**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

III. Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej **20.00 (njëzet) euro**, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmëris së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të dhunëshëm.

A r s y e t i m

1. Rrjedha e qështjes dhe fjala përfundimtare e palëve:

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithëshëm, më datë 15.12.2021 ka ngritur aktakuzën PP.II.Nr.568/2021, kundër të akuzuarit për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-s. Në shqyrtimin fillestar dhe publik të datës 11.05.2022, prezent ishin Prokurorja e shtetit Leonora Kadriu dhe i pandehuri ...në të cilën seancë pas leximit të aktakuzës, nga prokurorja e shteti, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe se e pranon fajësin për veprën penale që i vihet në barrë.

2. Vlersimi i pranimin të fajësisë:

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim më të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit, për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejt natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e qështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmbanë ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktik.

3. Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, ekziston fakti se i pandehuri e ka kryer veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1, të KPRK-s, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale:

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratës së palës lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të akuzuarin Ragip Sadiku për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njejtën është dhe penalisht përgjegjës:

Në bazë të nenit 314 të KPRK-s, Vjedhja e shërbimeve, konsiderohet:

1. Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
4. Për qëllime të këtij neni, “shërbime” përfshinë, por nuk kufizohet në transportimin; punën, shërbimet profesionale, teknike apo mekanike; shërbimet e skiliftit; objektet për biseda telefonikë; gazin, ujin, rrymën apo ngrohjen; shërbimet e komunikimit ose telefonisë; ofrimi i ushqimit apo akomodimit; furnizimi me pajisje, vegla, vetura ose kamp-shtëpiza përpërdorim të përkohshëm; furnizimi i pajisjeve për shfrytëzim; ose qasja në sistemin e internetit, kompjuterik apo kabllor. “Shërbim” po ashtu përfshinë çmimin e hyrjes në evenimente sportive, zbavitëse, shfaqje ose ngjarje tjera që kanë çmim të hyrjes ose tarifë tjetër për pjesëmarrje.
5. Për qëllime të këtij neni, vjedhja e shërbimeve të gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes përfshin, por nuk kufizohet në marrjen, përdorimin, devijimin, nxjerrjen ose përfitimin nga ndonjë shërbim i gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit;

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazur në nenin 69.70. 71 dhe 72 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njejtit t'i shqiptohet denimi me kusht, ngase duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale ashtu që për të akuzuarin si rrethanë posaqërisht lehtësuese e ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë, se i njejtë është penduar për veprën që ka bere është mares i ndihmes sociale ku vertetohet ne baze te nr.rendor nga Mireqenia Sociale me nr..... per Komunen e Gjilanit, i ka premtuar gjykatës se në të ardhme nuk do të kryej më vepër penale, Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti dënimin e shkaktuar, rrezikshmërin shoqërore dhe përgjegjësin penale.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e vepres penale dhe me shkallën e përgjegjësis penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar:

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimin i shqiptuar, ndaj të akuzuarit duke marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë dënim është i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësis penale të të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimine detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi kërkesën pasurore-juridike

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale:

Duke e pasur natyren e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata, duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për të paguar shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor.

Duke u bazuar në këto që u ceken si më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHËSHËM
P.nr: 1022/21, më datë: 11.05.2022**

Zyrtare Ligjore

Fikrije Rexhepi

Gjyqtari,

Veli Kryeziu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në gjykatën e Apelit në Prishtinë, departamentit të përgjithëshëm në afat prej 15 (pesëmbdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.